



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**ZP.Anr.47/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 29.12.2025, merr këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET e pabazuar** ankesa e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, ZP.Anr.47/2025, e datës 26.12.2025, parashtruar kundër subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 28 Dhjetor 2025.

**A r s y e t i m**

Me datë 26.12.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me të cilën pretendon se me datë 25.12.2025, mes orës 17:15 dhe 18:00, Veton Berisha, kryetar i PLE-së, gjatë intervistimit në emisionin "Frontal", televisionin T7, në lidhje me kryetarin e IRDK, Elbert Krasniqi, ka deklaruar se: *"Gjatë kësaj kohë të qeverisjes së z.Krasniqi, populli është varfëru. I vetmi ndryshim që ka ndodh në këto 4-5 vite është pasurimi i Ministrit, anëtarëve të tij dhe stafit të ngushtë, ku jemi saktë të bindur*

dhe kemi informacione se i vetmi ndryshim që ka ndodhur është ndryshimi i pozicionit të Ministrit dhe jo popullit...”. Parashtruesi i ankesës tutje shton se në pyetjen e gazetarit nëse Ministri është pasuruar në bazë të pagës nga puna e tij, Veton Berisha vazhdon me deklarin se: “ Nuk mundesh me arrit një pasurim të tillë, për faktin, që besoj se e dini, që ka pas hulumtime për dyshime për keqpërdorime të ndryshme. Sidomos projekti i shtëpive. Ai rast është në proces të hetimit. Kom informacion që (Elbert Krasniqi) minimumi pesë herë ka dhënë deklarata në krimet ekonomike dhe sigurisht ky proces do rrjedh më tutje” . Më tej në ankesë thuhet se në pyetjen e gazetarit nëse Ministri Krasniqi është ftuar nga hetuesit për këto dyshime, Veton Berisha vazhdon: “ Kam pasur informacione nga ajo që unë e di, pra nuk referohet në asnjë burim informacioni, por në “njohuritë” nga vetëdija ose hamendja e tij. E vërteta është se asnjë autoritet ose media nuk e ka raportuar për asnjë intervistim apo deklaratë të Elbert Krasniqit në “krimet ekonomike” apo Policinë e Kosovës, Drejtorinë për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit. Deklarimi i Veton Berishës se ka informacione, jep kuptim konstatues se një gjë e tillë ka ndodhur dhe ka qëllimin e qartë ta dëmtojë imazhin e Elbert Krasniqit, si dhe, përmes kësaj, të ndikojë tek votuesit gjatë fushatës zgjedhore. Tutje, ankuesi gjithashtu shton se në vijim të intervistës, Veton Berisha deklaroi se “z.Krasniqi ka prona gjithandej, në masë të madhe që nuk i ka emër të vet”, duke dhënë një konstatim të pavërtetë dhe të pabazuar në asnjë informacion të konfirmuar ose ndonjë aktgjykim gjykatë apo proces që do ta “legjitimonte” këtë konstatim.

Sipas parashtruesit të ankesës, shkelësi i supozuar, me këtë veprim subjekti politik PLE ka cenuar rëndë nenin 34, paragrafi 1.11, i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovës, i cili ndalon përdorimin e gjuhës, deklarimeve apo materialeve që nxisin, provokojnë ose mund të nxisin urrejtje, shpifje apo dëmtim të reputacionit të personave të tjerë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe Kodin e Sjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatët dhe parimit të barazisë dhe integritetit të garës zgjedhore.

Si dëshmi për pretendimet e tij, parashtruesi i ankesës, ka bashkangjitur një CD me pamje dhe audio e cila dëshmon të lartcekurat në këtë ankesë.

Në përgjigje në ankesë nga subjekti politik Partisë Liberale Egjiptiane- PLE, kanë pretenduar se kjo ankesë është paraqitur nga IRDK-ja pa arsye dhe pa bazë juridike ngase provat e dorëzuara e vërtetojnë të kundërtën e saj çka pretendohet me ankesë. Kryetari i PLE-së, Veton Berisha në intervistën e dhënë në emisionin Frontal në TV 7, gjatë deklaramit të tij ka përdorur

një gjuhë korrekte dhe të bazuar në argumente e prova që janë dalur dhe konstatuar nga institucionet e Republikës së Kosovës, saktësisht faktin se ministri Elbert Krasniqi në vitin 2021 ka deklaruar një pasuri dukshëm më të vogël nga ajo e vitit 2025 e që i bie se brenda mandatit i është rritur pasuria e ky fakt vërtetohet nga formularët e deklarimit të pasurisë. Tutje në përgjigje theksojnë, se asnjë deklarim i bërë nga z. Veton Berisha, nuk është bërë pa mbështetje ligjore dhe asnjë pjesë e deklarimit të tij nuk ka rënë ndesh apo kundërshtim me LZP, pasi që liria e shprehjes është një ndër liritë fundamentale të drejtave të njeriut dhe parashtruesi i ankesës ka për qëllim ndalimin/kufizimin të shprehjes, liri kjo e garantuar me të gjitha ligjet dhe aktet tjera juridike. Tutje, shtojnë se subjekti i tyre PLE është ndëshkuar me datën 22.12.2025 në shumën prej 2,000 euro përkundër se ky ndëshkim është bërë mbi bazën e paraqitjes të ankesës nga IRDK, paraqitja e ankesave të rreme dhe në mënyrë të pabazuar në prova e ligj. Prandaj, duke u bazuar në gjendjen faktike, provat që gjenden në shkresat e dorëzuara me këtë përgjigje në ankesë, në asnjë mënyrë nuk mund të vërtetohet se kryetari i PLE me deklaratimet e tij ka shkelur LZP apo Kodin e Sjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët dhe se ankesa nuk është arritur të elaborohet me asnjë provë tjetër nga parashtruesi i ankesës. Andaj, kërkojmë nga PZAP që ta refuzoj në tërësi ankesën e parashtruar. Në përgjigje në ankesë, subjekti politik PLE ka bashkangjitur dëshmi si linqe të intervistave, deklarimit të pasurisë dhe raporte më të cilat pretendojnë se me to dëshmojnë deklaratimet e Veton Berishës në intervistën e lartcekur.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

**-Ankesa është e pabazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoi se pretendimet e subjektit politik IRDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik PLE, Paneli i vlerësoj ne aspektin e lirisë se shprehjes dhe formës se shprehje dhe konkludoi se jo qdo akuze politike gjate fushatës zgjedhore mund te konsiderohet gjuhe urrejtëse.

Veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkeljet e pretenduara dhe se deklaratat e dhëna në intervistën e lartcekur nuk mund të konsiderohen si shkelje te Kodit te Sjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatët dhe parimit te barazisë dhe integritetit të garës nga se deklarimet e tilla konsiderohen diskurs politik i zakonshëm, e qe ne fushate zgjedhore kufijtë e kritikes politike mund te jenë me te gjere dhe se shiquar nga konteksti i intervistës se Veton Berishes, kryetar i PLE-së, gjatë intervistimit në emisionin “Frontal”, televisionin T7, deklarimet e tij paraqiten si vlerësime politike e jo si gjuhe qe mund te nxis akte te dhunes apo te nxis urrejtje.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankese dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë. Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZP.A.nr.47/2025, datë 29.12.2025

Kryesuese e Panelit

Kymete Kica



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi